

SALIM BIN SEAD TAUIL

**PYETJE - PËRGJIGJE FETARE
TË ADRESUARA FËMIJËVE,
POR TË CILAT EDHE TË
RRITURIT DUHET T'I DINË**



Titulli i origjinalit

أسئلة و أجوبة للصغار و لا يستغني عنها الكبار

Autori: Salim bin Sead Tauil

Përktheu: Edmond Ajdini

Redaktor fetar: Dr. Abdullah Nabolli, Shuajb Rexha



Boton:

Qendra Kulturore Fetare “Udha e Besimtarëve”

Rr. Kajo Karafili, Pll. 8, Shk. 1, Ap. 12, Tiranë, Albania

Tel.: +35542247064,

Mob.: +355 69 35 65 505, +355 67 25 67 863

e-mail: info@udhaebesimtareve.com

www.udhaebesimtarëve.com



Falënderimet dhe lëvdatat i takojnë Allahut, Një të Vetmit! Paqja, mëshira dhe bekimet qofshin mbi të Dërguarin e Tij; Muhamedin, pas të cilit nuk ka profet tjetër!

E në vijim:

Në këtë libërth do të gjeni një numër pyetjesh dhe përgjigjesh të cilat na njohin me një sërë njohurish bazë të fesë islame, lidhur me besimin, adhurimet, historinë profetike, dispozita të ndryshme fetare etj.

I kam përmbledhur në këtë trajtë të thjeshtësuar në mënyrë që fëmijët ta kenë sa më të lehtë mësimin e tyre përmendësh, si dhe që ta kenë të lehtë prindërit për t'ua mësuar fëmijëve të tyre.

Për përgatitjen e këtij libërthi shërbeu si shtysë fakti që shumë prindër dhe mësues e kanë të veshtirë përzgjedhjen e pyetjeve të përshtatshme për të dialoguar me fëmijët.

Këto pyetje-përgjigje, megjithëse kryesisht u adresohen fëmijëve, por në të vërtetë përmbajnë njohuri bazë të fesë islame të cilat të rriturit duhet t'i dinë patjetër.

Lus Allahun e Madhëruar që kjo vepër të jetë e dobishme për lexuesit, e sidomos për nxënësit dhe mësuesit!

Autori



PYETJET
DHE
PËRGJIGJET

1. Pyetja e parë: **Kush është Zoti yt?**

Përgjigjja: **Zoti im është Allahu i Madhëruar.**

2. Pyetja e dytë: **Ku është Allahu i Madhëruar?**

Përgjigjja: **Allahu i Madhëruar është mbi qiejt e lartë.**

3. Pyetja e tretë: **Cila është e drejta e Zotit kundrejt robërve të Tij?**

Përgjigjja: **E drejta e Zotit kundrejt robërve të Tij është që ta adhurojnë Atë, e të mos i shoqërojnë askënd dhe asgjë në adhurim.**

4. Pyetja e katërt: **Plotëso hadithin: I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kush thotë: Jam i kënaqur që Zoti im është Allahu...”**

Përgjigjja: “... Jam i kënaqur që feja ime është Islami dhe jam i kënaqur që Pejgamberi im është Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), këtij njeriu i bëhet obligim Xheneti.”¹

5. Pyetja e pestë: **Përse na ka krijuar Allahu i Madhëruar? Cili është argumenti?**

Përgjigjja: Allahu i Madhëruar na ka krijuar që ta adhurojmë Atë pa i shoqëruar askënd dhe asgjë në adhurim.

Allahu i Madhëruar thotë: “Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë.” *Dharijat, 56*

¹ E transmeton Ebu Daudi me nr 1529, nga sahabiu i nderuar Ebu Said el Hudriju (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!). Albani e ka vlerësuar këtë hadith ‘të saktë’, ashtu siç gjendet në librin e tij “Es Silsiletu Es Sahiha” me nr 334.

6. Pyetja e gjashtë: **Cili është obligimi ynë më i rëndësishëm?**

Përgjigjja: **Teuhidi (monoteizmi), i cili nënkupton njësimin e Allahut të Madhëruar në lidhje me gjithçka që Ai meriton të veçohet.**

7. Pyetja e shtatë: **Cilat janë tre llojet e Teuhidit?**

Përgjigjja:

1. **Teuhidi Rrububijeh (Njësimi i Allahut në zotërim).**²
2. **Teuhidi Uluhijeh (Njësimi i Allahut në adhurim).**³
3. **Teuhidi El Esmau ue Sifat (Njësimi i Allahut në emrat dhe cilësitë e Tij të përsosura).**⁴

² Me ‘Teuhidin Rrububijeh’ është për qëllim pohimi me bindje të thellë dhe besim të plotë se vetëm Allahu i Madhëruar është Krijuesi, Furnizuesi, Mirëbërësi, Drejtuesi, Sistemuesi i të gjitha çështjeve, të cilat kanë të bëjnë me krijesat e Tij!

³ Me ‘Teuhidin Uluhije’ është për qëllim veçimi i Allahut të Madhëruar me adhurim, të përkushtuarit e fesë vetëm Atij dhe refuzimi i idhujtarisë me të gjitha llojet dhe shfaqjet e saj.

⁴ Me ‘Teuhidin El Esmau ue Sifat’, është për qëllim të besojmë dhe të pohojmë me vendosmëri të plotë emrat e bukur të Allahut të Madhëruar dhe cilësitë e përsosura të Tij, të cilat përmenden në Librin e Tij dhe në thëniet profetike.

8. Pyetja e tetë: **Ç'është dëshmia e Teuhidit dhe cila është domethënia e saj?**

Përgjigjja: Dëshmia e Teuhidit është fjala *'La ilahe il Allah'*. Domethënia e kësaj fjalë është: *'Nuk ka të adhuruar tjetër të vërtetë përveç Allahut'*.

9. Pyetja e nëntë: **Plotëso hadithin: I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Cilido që dëshmon 'La ilahe il Allah ue en-ne Muhameden resulullah...'⁵**

Përgjigjja: "... me sinqeritet nga thellësia e zemrës së tij, do të jetë haram për të zjarri (do të shpëtojë nga zjarri i xhehenemit)."⁶

⁵ 'Nuk ka të adhuruar tjetër të vërtetë përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguar i Allahut'

⁶ E transmeton Buhariu me nr 128, Muslimi me nr 32, nga Enes bin Maliku (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

10.Pyetja e dhjetë: **Cili është gjynahu më i madh?**

Përgjigjja: **Shirku (Idhujtaria).**

11.Pyetja e njëmbëdhjetë: **Ç’është Shirku?**

Përgjigjja: **Adhurimi i çdo gjëje tjetër përveç Allahut ose sëbashku me Allahun.**

12.Pyetja e dymbëdhjetë: **Plotëso hadithin: I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kush betohet në diçka apo dikë tjetër përveç Allahut...”**

Përgjigjja: **“... ka mohuar ose ka bërë idhujtari.”⁷**

⁷ E transmeton Tirmidhiu me nr 1535, nga sahabiu i nderuar Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!). Albani e ka vlerësuar këtë hadith ‘të saktë’, ashtu siç gjendet në librin e tij “Es Silsiletu Es Sahiha” me nr 2042.

13.Pyetja e trembëdhjetë: **A mund ta dijë të fshehtë dikush tjetër përveç Allahut? Cili është argumenti?**

Përgjigjja: Të fshehtë nuk e di askush tjetër përveç Allahut të Madhëruar. Argument për këtë është fjala e Allahut në Kuran: “Thuaj: Askush përveç Allahut, në qiej apo në Tokë, nuk mund ta dijë të fshehtën.” *Neml, 65*

14.Pyetja e katërbëdhjetë: **Çfarë kriteri duhet të plotësojnë veprat e mira që të jenë të pranuar tek Allahu i Madhëruar?**

Përgjigjja: Duhet të kryhen me sinqeritet për hir të Allahut dhe në përputhje me traditën profetike.

15. Pyetja e pesëmbëdhjetë: **Cila sure e ka shpërblimin sa një e katërta e Kuranit? A mund ta recitosh?**

Përgjigjja: Sureja që e ka shpërblimin sa një e katërta e Kuranit është Sureja El Kafirun.

Bismilahi Rrahmani Rrahim

**Kul ja ejuhel kafirun
La eabudu ma teabudun
Ue la entum abidune ma eabud
Ue la ene abidum ma abed-tum
Ue la entum abidune ma eabud
Lekum dinukum ue lijedin**

**“Me emrin e Allahut, të
Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit!**

**“Thuaj: “O ju mosbesimtarë!
Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni.
As ju nuk jeni adhurues
të Atij që unë adhuroj.
Unë nuk do të jem kurrë
adhurues i atyre (idhujve)
që ju i adhuroni
dhe as ju nuk do të jeni
adhurues të Atij që unë adhuroj!
Ju keni fenë tuaj,
ndërsa unë kam fenë time!”**

El Kafirun, 1-6

16. Pyetja e gjashtëmbëdhjetë: **Cili është Profeti ynë?**

Përgjigjja: Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), i Dërguari i Allahut.

17. Pyetja e shtatëmbëdhjetë: **Çfarë kuptojmë me fjalët 'Muhamedi i Dërguari i Allahut'? Çfarë na obligon kjo fjalë?**

Përgjigjja: Kjo do të thotë se: Allahu i Madhëruar e dërgoi Muhamedin si mëshirë për mbarë njerëzimin, e njëkohësisht si përgëzues për punëmirët dhe qortues për keqbërësit.

Duke e pohuar këtë, ne obligohemi që:

- Të besojmë çdo gjë për të cilën ai na ka lajmëruar.
- Të jemi të dëgjueshëm në lidhje me çfarë ai na ka urdhëruar.
- Të distancohemi nga çfarë ai na ka ndaluar dhe ka tërhequr vërejtje.
- Ta adhurojmë Allahun vetëm sipas mënyrës që ai na ka mësuar.

18.Pyetja e tetëmbëdhjetë: **A e di emrin e plotë të Profetit tonë, duke përmendur emrin e babait dhe gjyshit të tij?**

Përgjigjja: **Ai është Muhamed bin Abdilah bin Abdilmutalib.**

19.Pyetja e nëntëmbëdhjetë: **Kush është njeriu të cilin duhet ta duam më tepër se çdokënd tjetër? Cili është argumenti?**

Përgjigjja: **Ai është i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!). Argument për këtë është fjala e tij: “Asnjëri prej jush nuk do ta ketë besimin të plotë derisa unë të jem për të më i dashur sesa prindi i tij, fëmija i tij apo mbarë njerëzimi.”⁸**

⁸ E transmeton Buhariu me nr 15, nga Enes bin Maliku (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

20. Pyetja e njëzetë: **Kur lindi Profeti (Paqja qoftë mbi të!) dhe në cilin vend?**

Përgjigjja: **Lindi në qytetin e Mekës, në vitin 570, i cili njihet si ‘Viti i Elefantit’⁹.**

21. Pyetja e njëzetënjëtë: **Në çfarë moshe i erdhi Profetit shpallja hyjnore?**

Përgjigjja: **Kur ai ishte dyzet vjeç.**

22. Pyetja e njëzetedytë: **Sa vite qëndroi Profeti (Paqja qoftë mbi të!) në Mekë, që nga momenti i fillimit të shpalljes e deri kur u detyrua të emigronte?**

Përgjigjja: **Trembëdhjetë vite.**

⁹ Njihet me këtë emërtim, për shkak se në atë vit një sundimtar etiopias i cili quhej Abraha formoi një ushtri me të cilën u nis për të shembur Qaben dhe në krye të saj kishte vënë një elefant gjigand. Allahu i Madhëruar e mori në mbrojtje faltoren e lashtë (Qaben) duke e shkatërruar ushtrinë e Abrahas, ashtu siç përmendet në Kuran, në suren Fil.

23.Pyetja e njëzetetretë: **Në cilin vend emigroi Profeti (Paqja qoftë mbi të!)?**

Përgjigjja: Në Medine.

24.Pyetja e njëzetekatërt: **Sa vite jetoi Profeti (Paqja qoftë mbi të!) në Medine, pas hixhretit (emigrimit)?**

Përgjigjja: Dhjetë vite.

25.Pyetja e njëzetepestë: **Cilat kemi për qëllim kur themi ‘nënat e besimtarëve’?**

Përgjigjja: Bashkëshortet e profetit Muhamed (Paqja qoftë mbi të!).

26.Pyetja e njëzetegjashtë: **Kur ndërroi jetë Profeti (Paqja qoftë mbi të!), në cilin vend dhe në çfarë moshe?**

Përgjigjja: Ndërroi jetë në Medine, dhjetë vjet pas hixhretit në moshën 63 vjeçare.

27.Pyetja e njëzeteshtatë: **Plotëso hadithin: I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kush dërgon salavat për mua një herë...**

28.Përgjigjja: ... Allahu do të dërgojë për të dhjetë herë.”¹⁰

29.Pyetja e njëzetetë: **Cila është feja jote?**

Përgjigjja: **Feja ime është Islami.**

30.Pyetja e njëzetënëntë: **Çfarë do të thotë ‘Islam’?**

Përgjigjja: **Islam do të thotë t’i dorëzohesh Allahut duke e njësuar Atë, t’i përmbahesh me zell urdhëresave të Tij, si dhe të distancohesh nga idhujtaria.**

¹⁰ E transmeton Muslimi me nr 408, nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

31.Pyetja e tridhjetë: **Sa shtylla ka Islami dhe cilat janë ato? Cili është argumenti?**

Përgjigjja: Islami ka pesë shtylla.

Argument për këtë është fjala e Profetit (Paqja qoftë mbi të!):

“Islami ngrihet mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, kryerja e haxhit (pelegrinazhit në Mekë) dhe agjërimi i muajit Ramazan.”¹¹

32.Pyetja e tridhjetenjë: **Cila është shtylla mbajtëse e fesë?**

Përgjigjja: Falja e namazit.

¹¹ E transmeton Buhariu me nr 8 dhe Muslimi me nr 16.

33. Pyetja e tridhjetedytë: **Plotëso hadithin: I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Shenja dalluese mes nesh dhe atyre (jomuslimanëve) është namazi...**

Përgjigjja: ...prandaj, kush e braktis atë, ka mohuar.”¹²

34. Pyetja e tridhjetetretë: **Cili është përkufizimi (definicioni) i namazit?**

Përgjigjja: Namazi është: Adhurimi i Allahut me fjalë dhe veprime të caktuara. Fillon me tekbir (thënien ‘*Allahu ekber*’) dhe përfundon me teslim (thënien ‘*Esselamu alejkum ue rahmetullah!*’).

¹² E transmeton Tirmidhiu me nr 2623 dhe Ibën Maxheh me nr 1079, nga Burejdeh (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!). Albani e ka vlerësuar këtë hadith ‘të saktë’, ashtu siç gjendet në librin e tij “Sahihu tergib uet Terhib” me nr 564.

35. Pyetja e tridhjetekatërt: **Sa është numri i namazeve të obligueshme të cilat muslimani duhet t'i falë gjatë një ditë-nate (njëzet e katër orëve) dhe sa rekatë ka secili namaz?**

Përgjigjja: Gjatë një ditë-nate (çdo njëzetekatër orë), muslimani obligohet të falë pesë namaze:

- **Namazin e mëngjesit (Sabahun):**
Dy rekatë
- **Namazin e drekës (Ylenë):** Katër rekatë
- **Namazin e pasdites (Ikindinë):**
Katër rekatë
- **Namazin e mbrëmjes (Akshamin):**
Tre rekatë
- **Namazin e darkës (Jacinë):**
Katër rekatë

36. Pyetja e tridhjetepestë: **Cilat janë kriteret që duhet të plotësohen për të qenë namazi i saktë?**

Përgjigjja:

1. Ai që falet duhet të jetë musliman
2. Të jetë i saktë mendërisht
3. Të jetë rritur aq sa është i aftë të kuptojë
4. Të ketë hyrë koha e namazit
5. Të largojë çdo papastërti nga trupi, rrobat dhe vendi i faljes
6. Të jetë i pastër (me abdes)
7. Të mbulojë aurretin (pjesët e trupit që duhen mbuluar)
8. Të drejtohet nga Kibla (Qabeja)
9. Të bëjë nijet faljen e namazit

37. Pyetja e tridhjetegjashtë: **Cilat janë farzet (obligimet) e abdesit?**

Përgjigjja:

1. Larja e fytyrës, ku bën pjesë edhe shpëlarja e gojës dhe e hundës.
2. Larja e duarve, parakrahëve, duke përfshirë dhe bërrylat.
3. Fërkimi i kokës një herë me duar të lagura.
4. Larja e këmbëve, duke përfshirë edhe kyçet.
5. Ruajtja e radhitjes së veprimeve gjatë larjes së pjesëve të abdesit.
6. Vijueshmëria. Të mos e vonojë larjen e ndonjë gjymtyre aq sa të mund të konsiderohet si ndërprerje e marrjes së abdesit.

38.Pyetja e tridhjeteshtatë: **Çfarë e prish abdesin?**

Përgjigjja:

1. Çdo gjë që del nga organi gjenital dhe anusi, siç janë urina, jashtëqitja, gazrat etj
2. Humbja e vetëdijes për shkak të gjumit të thellë apo gjendjes së të fiktit
3. Ngrënia e mishit të devesë
4. Çdo gjë që e bën të obligueshëm marrjen e gusulit¹³, natyrisht që prish edhe abdesin.

39.Pyetja e tridhjetetetë: **Plotëso hadithin: I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kush merr abdes dhe pastaj thotë: ‘Esh-hedu en la ilahe il-lall-llah uahdehu la sherike lehu...**

Përgjigjja: ”... ue esh-hedu en-ne Muhameden abduhu ue resuluhu’ do të hapen për të tetë dyert e Xhenetit që të hyjë nga cila derë të dëshirojë.”¹⁴

¹³ Gusuli është larja e gjithë trupit, për shkak të ejakulimit dhe kryerjes së marrëdhënieve intime.

¹⁴ E transmeton Muslimi me nr 234.

40. Pyetja e tridhjetenëntë: **Cila sure duhet të lexohet patjetër në namaz?**

Përgjigjja: Surjea El Fatiha (Elhamdulilahi Rabbil alemin...)

41. Pyetja e dyzetë: **Çfarë themi gjatë faljes kur qëndrojmë në ruku?**

Përgjigjja: “Subhane Rabijel-adhim” (I Dëllirë nga çdo e metë është Allahu, Zoti im i Madhërishëm)

42. Pyetja e dyzetënjëtë: **Çfarë themi gjatë qëndrimit në sexhde?**

Përgjigjja: “Subhane Rabijel-ala” (I Dëllirë nga çdo e metë është Allahu, Zoti im i Lartësuar)

43. Pyetja e dyzetedytë: **Çfarë themi gjatë pushimit midis dy sexhdeve?**

Përgjigjja: “Rabi-gfirli, Rabi-gfirli” (O Zot më fal mua! O Zot më fal mua!)

44. Pyetja e dyzetetretë: **Çfarë themi gjatë qëndrimit ulur në teshehud?**

Përgjigjja: **Themi *Et-Tehijatin***, “Et-tehijatu lilahi, ues salavatu uet-tajibatu. Ues selamu alen-Nebij ue rahmetullahi ue beraketuh.

Es-selamu alejna ue ala ibadilahi salihin. Esh-hedu en la ilahe il-lall-llah, uahdehu la sherike leh. Ue esh-hedu enne Muhameden abduhu ue resuluhu”¹⁵

45. Pyetja e dyzetekatërt: **Çfarë themi pas et-tehijatit?**

Përgjigjja: **Pas *Et-Tehijatit* themi ‘*Salavatet Ibrahimijeh*’ :**

“Allahume sal-li ala Muhamedin ue ala ali Muhamed, kema sal-lejte ala Ibrahimie ue ala ali Ibrahim. Inneke hamidun mexhid. Allahume barik ala Muhamedin ue ala ali Muhamed, kema berakte ala Ibrahimie ue ala ali Ibrahim. Inneke hamidun mexhid.”¹⁶

¹⁵ E transmeton Buhariu me nr 6230, Muslimi me nr 402, nga Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

¹⁶ E transmeton Buhariu me nr 3370, Muslimi me nr 406, nga Keab bin Uxhrah (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

46.Pyetja e dyzetepestë: **Cilat janë ato katër gjëra prej të cilave besimtari i kërkon mbrojtje Allahut të Madhëruar, në mbyllje të namazit; përpara se të japë selam?**

Përgjigjja: **I kërkon mbrojtje Allahut duke thënë “Allahume ini eudhu bike min adhabi xhehenem, ue min adhabil kabr, ue min fitnetil mah-ja uel memmat, ue min sherri fitnetil mesihi dexhal!”**¹⁷

47.Pyetja e dyzetegjashtë: **Plotëso hadithin: I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Çdo muslimani i cili i fal për Allahun e Madhëruar përveç farzeve edhe dymbëdhjetë rekate sunet...”**

Përgjigjja: **”... Allahu do t’i ndërtojë një shtëpi në Xhenet.”**¹⁸

¹⁷ E transmeton Muslimi me nr 588.

¹⁸ E transmeton Muslimi me nr 768, nga Umu Habibeh (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!).

48.Pyetja e dyzeteshtatë: **Cilat janë dymbëdhjetë rekatët sunet të rëndësishme (rauatib)?**

Përgjigjja: Ato janë:

- 2 rekatë para namazit të sabahut
- 4 rekatë para namazit të drekës
- 2 rekatë pas namazit të drekës
- 2 rekatë pas namazit të akshamit
- 2 rekatë pas namazit të jacisë

49.Pyetja e dyzetetë: **Cili është përkufizimi i Zekatit?**

Përgjigjja: Zekati është: “Një detyrim pasuror i cili jepet në masë të caktuar, nga disa lloje të pasurisë, një herë në vit, nga i cili përfitojnë disa kategori të caktuara njerëzish.”

50.Pyetja e dyzetënëntë: **Cili është përkufizimi i Agjërimit?**

Përgjigjja: **Agjërimi është: “Të adhurosh Allahun duke e privuar veten qëllimisht, nga ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet intime, që nga shfaqja e agimit e deri në perëndimin e diellit.”**

51.Pyetja e pesëdhjetë: **Plotëso hadithin: I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kush e agjëron Ramazanin me besim dhe duke shpresuar shpërblimin...**

Përgjigjja: **“... do t`i falen mëkatet që i ka bërë më herët.”¹⁹**

¹⁹ E transmeton Buhariu me nr 38 dhe Muslimi me nr 760, nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

52.Pyetja e pesëdhjetenjëte: **Cili është përkufizimi i Haxhit (pelegrinazhit në Mekë)?**

Përgjigjja: Haxhi është: “Të adhurosh Allahun duke vizituar shtëpinë e shenjtë (Qaben) për të kryer në të disa rituale të caktuara, në një periudhë të caktuar të vitit.”

53.Pyetja e pesëdhjetedytë: **Plotëso hadithin: I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kush kryen Haxhin duke iu ruajtur epshit të vet dhe duke u distancuar nga mëkatet...**

Përgjigjja: ... do të kthehet si ditën që e ka lindur nëna e tij (qelibar, pa gjynahe).”²⁰

²⁰ E transmeton Buhariu me nr 1521, nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

54. Pyetja e pesëdhjetetretë: **Cilat janë Bazat e Besimit?**

Përgjigjja: **Bazat e Besimit janë: Besimi në Allahun, Engjëjt e Tij, Librat e Tij, Profetët e Tij, në Ditën e Fundit, si dhe besimi në Paracaktimin, i mirë qoftë ai, apo i keq.**

55. Pyetja e pesëdhjetetretë: **Përmend emrat e tre engjëjve!**

Përgjigjja: **Xhibrili, Mikaili dhe Israfil (Paqja e Zotit qoftë mbi ta!).**

56.Pyetja e pesëdhjetepeshtë: **Cilat janë Librat e shpallur nga Allahu dhe cilëve profetë u janë zbritur?**

Përgjigjja:

1. **Teurati, i cili i zbriti Musait** (Paqja qoftë mbi të!).
2. **Ungjilli, i cili i zbriti Isait** (Paqja qoftë mbi të!).
3. **Zeburi, i cili i zbriti Daudit** (Paqja qoftë mbi të!).
4. **Fletushkat, të cilat i zbritën Ibrahimit dhe Musait** (Paqja qoftë mbi ta!).
5. **Kurani famëmadh, i cili i zbriti Muhamedit** (Paqja qoftë mbi të!).

57.Pyetja e pesëdhjetegjashtë: **Cilët ishin të dërguarit më të dalluar (Ulul azmi)?**

Përgjigjja:

1. **Nuhu** (Paqja qoftë mbi të!)
2. **Ibrahimi** (Paqja qoftë mbi të!)
3. **Musai** (Paqja qoftë mbi të!)
4. **Isai** (Paqja qoftë mbi të!)
5. **Muhamedi** (Paqja qoftë mbi të!)

58.Pyetja e pesëdhjeteshtatë: **Cilët janë ajetet në fundin e sures El Bekare të cilat preferohet që të lexohen çdo natë?**

Përgjigjja: Ato janë dy ajetet e fundit të sures El Bekare:

“Amene Rasulu bi ma unzile ilejhi min Rabbihi uel mu’minun.

Kul-lun amene bil-lahi ue melaiketihii ue kutubihii ue rusulih.

La nuferriku bejne ehadin min rusulih. Ue kalu semia’na ue eta’na, gufraneke Rabena ue iljekel mesir.

La jukelifullahu nefsen il-la vus’aha. Leha ma kesebet ue alejha mektesebet. Rab-bena la tuakhidhna in nesijna eu ekhta’na!

Rab-bena ue la tehnil alejna isran kema hameltehu alel-ledhine min kablina!

Rab-bena ue la tuham-milna ma la takate lena bih!

Ue’afu an-na, uegfir lena, uerhamna! Ente meulana, fensurna alel kaumil kafirin!”

“I Dërguari beson në atë (Kuranin) që i është shpallur nga Zoti i tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të dërguarit e Tij (duke thënë): “Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij”.

Ata thonë: “Ne dëgjojmë dhe bindemi. Faljen Tënde kërkojmë, o Zoti Ynë dhe tek Ti do të kthehemi!”

Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka: në dobi të tij është e mira që bën, kurse në dëm të tij është e keqja që punon.

Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë ose veprojmë pa qëllim!

Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu siç i ngarkove ata para nesh!

Zoti ynë, mos na ngarko me diçka që nuk mund ta bartim!

Na i shlyej gjynahet tona, na i fal ato dhe na mëshiro!

Ti je Zoti Ynë! Na jep fitore kundër atyre që nuk besojnë!”

59. Pyetja e pesëdhjetetë: **Kur do të ndodhë Kijameti? Cili është argumenti?**

Përgjigjja: Vetëm Allahu i Madhëruar e di se kur do të ndodhë Kijameti. Askush tjetër përveç Tij nuk e di se kur do të ndodhë. Argument për këtë është ajeti kuranor:

“S’ka dyshim se vetëm Allahu e di kur do të ndodhë Kijameti...” *Lukman, 34*

60. Pyetja e pesëdhjetenëntë: **Cili është ‘vendbanimi i nderimit’? Sa dyer ka?**

Përgjigjja: ‘Vendbanimi i nderimit’ është Xheneti, i cili ka tetë dyer.

61. Pyetja e gjashtëdhjetë: **Cila do të jetë kënaqësia më e madhe në Xhenet?**

Përgjigjja: Kënaqësia më e madhe që do të përjetojnë besimtarët në Xhenet do të jetë kur të shohin Zotin e Madhëruar.

62.Pyetja e gjashtëdhjetenjëte: **Çfarë i fut më së tepërmi njerëzit në Xhenet?**

Përgjigjja: Devotshmëria ndaj Zotit dhe morali i mirë.

63.Pyetja e gjashtëdhjetedytë: **Cili është 'vendi i vuajtjeve', i dënimit dhe përçmimit? Sa dyer ka?**

Përgjigjja: Vendi i vuajtjeve, i dënimit dhe përçmimit është xhehenemi (ferri), i cili ka shtatë dyer.

64.Pyetja e gjashtëdhjetetretë: **Ç'është 'grada e përsosmërisë' në besim (Ihsani)?**

Përgjigjja: Grada e përsosmërisë në besim është ta adhurosh Allahun sikur të jesh duke e parë Atë, e pavarësisht se ti nuk e sheh, Ai të shikon ty.

65. Pyetja e gjashtëdhjetekatërt: **Kush janë ata që më së shumti e meritojnë respektin, mirësjelljen dhe përkujdesjen tënde?**

Përgjigjja: Prindërit; nëna dhe babai.

66. Pyetja e gjashtëdhjetepesë: **Çfarë themi kur lutemi për prindërit tanë?**

Përgjigjja: **Themi: “O Zoti im! Falmë mua dhe fali prindërit e mi! Mëshiroji ata dhe përkujdesu për ta ashtu siç ata u përkujdesën për mua kur isha i vogël!”**

67. Pyetja e gjashtëdhjetegjashtë: **Cilat janë veprat më të dashura tek Allahu i Madhëruar?**

Përgjigjja: **Falja e namazit në kohën e caktuar, respektimi i prindërve dhe përpjekja e gjithanshme në rrugën e Zotit.**

68. Pyetja e gjashtëdhjeteshtatë: **Cilët janë njerëzit më të nderuar tek Zoti?**

Përgjigjja: Ata që janë më të devotshëm. E padyshim që njeriu më i devotshëm nga të gjithë ishte i Dërguari i Allahut, Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!).

69. Pyetja e gjashtëdhjetetetë: **Cili libër është më madhështori? Sa xhuze (pjesë) ka ai?**

Përgjigjja: Libri më madhështor është Kurani, i cili ka tridhjetë xhuze.

70. Pyetja e gjashtëdhjetenëntë: **Çfarë duhet të bëjmë para se të fillojmë të lexojmë Kuranin?**

Përgjigjja: Të marrim abdes dhe të themi: Eudhu bil-lahi mine shejtani rraxhim!

71. Pyetja e shtatëdhjetë: **Cilat sure janë quajtur ‘Dy mbrojtëset’?**

A mund t’i recitosh ato?

Përgjigjja: **Ato janë sureja Felek dhe sureja Nas.**

Sureja FELEK

Bismilahi Rrahmani Rrahim

Kul eudhu bi Rab-bil felek

Min sherri ma khalek

Ue min sherri gasikin idhe uekab

Ue min sherri nefathati fil-ukad

Ue min sherri hasidin idhe hased

**“Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit!**

**“Thuaj: ‘Kërkoj mbështetje
te Zoti i agimit,
që të më mbrojë nga sherri
i gjithçkaje që Ai ka krijuar,
dhe nga sherri i natës,
kur kaplon errësira
dhe nga sherri i falltarëve, që fryjnë
në nyje (duke bërë magji),
dhe nga sherri i smirëziut,
kur vepron me smirë.”**

Felek, 1-5

Sureja NAS

Bismilahi Rrahmani Rrahim

Kul eudhu bi Rab-bin – nas

Melikin – nas

Ilahin – nas

Min sherril ues-uasil khan – nas

El-ledhi juvesvisu fi sudurin – nas

Minel xhin-neti uen - nas

**“Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit!**

**“Thuaj: “Kërkoj mbështetje
te Zoti i njerëzve,
Sundimtari i njerëzve,
i Adhuruari (i vetëm
me të drejtë) i njerëzve,
nga sherri i djallit cytës
që fshihet (pasi cyt)
e që hedh dyshime
në gjokset e njerëzve,
(qoftë ai djall) prej xhindeve
apo njerëzve!”**

Nas, 1-6

72. Pyetja e shtatëdhjetenjë: **Cili është ajeti më madhështor në Kuran?**

Përgjigjja: Ajeti Kursij.

“Allahu, la ilahe il-la huve, el-hajjul-kajjum. La te’hudhuhu sinetun ue la neum. Lehu ma fis-semauati ue ma fil-ard. Men dhe-ledhi jeshfeu indehu il-la bi’idhnih. Jealemu ma bejne ejdihim ue ma halfehum. Ue la juhijtune bishej’in min ilmihi il-la bima sha’e. Uesia kursijuhus-semauati uel-ard. Ue la jeu-duhu hifdhuhuma, ue huvel-alijjul-adhim.”

“Allahu! Nuk ka të adhuruar tjetër (të denjë) përveç Tij, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në tokë. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai pa lejen e Tij?! Ai di gjithçka që ka ndodhur para krijesave dhe gjithçka që do të ndodhë pas tyre, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga dija e Tij, përveç asaj që Ai do. Kursija e Tij përfshin qiejt dhe Tokën dhe Atë nuk e lodh ruajtja e tyre (qiejve dhe Tokës). Ai është i Larti, Madhështori.”

73.Pyetja e shtatëdhjetedytë: **Plotëso hadithin: I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kush e lexon ajetin Kursij pas çdo namazi (farz)...**

Përgjigjja: “... nuk e pengon asgjë nga hyrja në Xhenet veç vdekjes.”²¹

74.Pyetja e shtatëdhjetetretë: **Cila është sureja më madhështore në Kuran? A mund ta recitosh atë?**

Përgjigjja: **Sureja më madhështore në Kuran është sureja El Fatiha.**

²¹ E transmeton En Nesai në “El Kubra” me nr 9928, nga Ebi Umameh (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!). Albani e ka vlerësuar këtë hadith ‘të saktë’, ashtu siç gjendet në librin e tij “Sahihu tergib uet Terhib” me nr 1595.

Bismilahi Rrahmani Rrahim

**Elhamdu Lil-lahi Rab-bil Alemin
Err-Rrahmani Rrahim
Maliki jeumid-din
Ijjake neabudu ue ij Jake nestein
Ihdinas-siratal mustekim
Siratal-ledhine en'amte alejhim
Gajril magdubi alejhim ue led-dal-lin”**

**Me emrin e Allahut, të
Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit!**

“Çdo lavdërim i përket Allahut,
Zotit të botëve,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit,
Sunduesit të Ditës së Gjykimit.
Vetëm Ty (o Zot) të adhurojmë
dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.
Udhëzona në rrugën e drejtë!
Në rrugën e atyre që u ke dhuruar
mirësi, e jo në të atyre që kanë
shkaktuar zemërimin Tënd,
e as në të atyre që janë të humbur!”

El Fatiha, 1-7

75.Pyetja e shtatëdhjetekatërt: **Cila është sureja më e gjatë në Kuran?**
Përgjigjja: Sureja më e gjatë në Kuran është sureja El Bekare.

76.Pyetja e shtatëdhjetepesë: **Cila është sureja më e shkurtër në Kuran? A mund ta recitosh atë?**

Përgjigjja: Sureja më e shkurtër në Kuran është sureja El Keuther.

Bismilahi Rrahmani Rrahim

In-na eatajnakek-keuther
Fe sal-li li Rab-bike uen-har
In-ne shani'eke huvel ebter

“Me emrin e Allahut, të
Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit!

“Me të vërtetë që
Ne të kemi dhënë ty shumë të mira
Andaj, ti falu për
Zotin tënd dhe ther kurban!
E s’ka dyshim se ai që të urren ty
(o Muhamed), ai do të jetë i shfarosur.”
El Keuther, 1-3

77. Pyetja e shtatëdhjetegjashtë: **Cila është ajo sure e cila ka vlerë sa një e treta e Kuranit? A mund ta recitosh atë?**

Përgjigjja: Sureja e cila ka vlerë sa një e treta e Kurani është Sureja El Ikhlas.

Bismilahi Rrahmani Rrahim

Kul huvallahu ehad
Allahu Samed
Lem jelid ue lem juled
Ue lem jekul-lehu kufuven ehad

“Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit!

Thuaj: “Ai është Allahu,
Një dhe i Vetëm!
Allahu është Ai, të Cilit
ia ka nevojën çdokush.
Ai as nuk lind,
as nuk është i lindur.
Dhe askush nuk
është i barabartë (apo i
krahasueshëm) me Atë!”

El Ikhlas, 1-3

78.Pyetja e shtatëdhjeteshtatë: **Plotëso suren në vijim: “Uel asër! Innel insane lefi khusër...**

Përgjigjja: “... Il-le ledhine amenu ue amilus-salihati, ue teuasau bil-hakki ue teuasau bis-sabër.” *El Asër, 1-3*

79.Pyetja e shtatëdhjetetetë: **Cili është morali më i vyer dhe cili është vesi më i shëmtuar?**

Përgjigjja: Padyshim që morali më i vyer është: Singëriteti, ndërsa vesi më i shëmtuar është gënjeshtër.

80.Pyetja e shtatëdhjetenëntë: **Plotëso hadithin: I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Asnjëri nga ju nuk ka besuar ashtu siç duhet ...**

Përgjigjja: “... derisa të dojë për vëllanë e tij atë të mirë që do për vete.”²²

²² E transmeton Buhariu me nr 13, Muslimi me nr 45, nga Enes bin Maliku (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

81.Pyetja e tetëdhjetë: **Kush është armiku yt më i përbetuar?**

Përgjigjja: Shejtani i mallkuar.

82.Pyetja e tetëdhjetenjë: **Kur i kërkojmë mbrojtje Allahut nga shejtani i mallkuar?**

Përgjigjja:

1. Para se të lexojmë Kuran
2. Para se të hyjmë në tualet
3. Kur jemi të nevrikosur
4. Kur na shkon mendja për të këqia apo kemi vesvese djallëzore
5. Kur dëgjojmë pëllitjen e gomarit

83.Pyetja e tetëdhjetedytë: **Cili nga veset e brendshme është më i dëmshmi?**

Përgjigjja: Nifaku (dyfytërsia, hipokrizia).

84.Pyetja e tetëdhjetetretë: **Cilat namaze janë më të vështirat për munafikët (ata që shtiren)?**

Përgjigjja: Namazi i Sabahut dhe namazi i Jacisë.

85.Pyetja e tetëdhjetekatërt: **Plotëso hadithin: I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Shenjat e hipokritit janë tre: Kur flet gënjen...**

Përgjigjja: “...kur premtion e thyen premtimin, e kur i besohet diçka, tradhëton.”²³

86.Pyetja e tetëdhjetepesë: **Çfarë ia rrezikon më tepër fenë muslimanit?**

Përgjigjja: Mëkatet e gjuhës së tij.

²³ E transmeton Buhariu me nr 33 dhe Muslimi me nr 59, nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

87.Pyetja e tetëdhjetegjashtë: **Plotëso hadithin: I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Nga islami i mirë i njeriut është...**

Përgjigjja: “... largimi nga ajo që nuk i intereson.”²⁴

88.Pyetja e tetëdhjeteshtatë: **Cilat janë fjalët më të dashura tek Allahu i Madhëruar?**

Përgjigjja: “Subhanallah, Elhamdulillah, La ilahe il-lallah, Allahu ekber!”
(I Dëlirë nga çdo e metë dhe mangësi është Allahu, Atij i takon Lavdërimi, S’ka të adhuruar tjetër të vërtetë përveç Allahut. Allahu është më i madhi!).

²⁴ E transmeton Tirmidhiu me nr 2317 dhe Ibën Maxheh me nr 3976, nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!). Albani e ka saktësuar këtë hadith, ashtu siç gjendet në librin e tij “Sahihu tergib uet Terhib” me nr 2881.

89.Pyetja e tetëdhjetetë: **Cila lutje është quajtur ‘Thesar i Xhenetit’**

Përgjigjja: “La haule ue la kuvete il-la bil-lah!”

(S’ka ndryshim e as fuqi pa ndihmën e Allahut!).

90.Pyetja e tetëdhjetenëntë: **Plotëso hadithin: I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Dy fjalë janë të lehta për gjuhën...**

Përgjigjja: “... janë të rënda në Peshoren e Ditës së Gjykimit dhe janë të dashura tek Mëshiruesi: “Subhanallahi ue bihamdihi, Subhanallahil Adhim”

(I Dëlirë nga çdo e metë dhe mangësi është Allahu, Atij i takon Lavdërimi. I Dëlirë nga çdo e metë dhe mangësi është Allahu, i Madhërishmi)”²⁵

²⁵ E transmeton Buhariu me nr 7563 dhe Muslimi me nr 2694, nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

91. Pyetja e nëntëdhjetë: **Cila është forma më e mirë e kërkimit të faljes?**

Përgjigjja:

“Allahume ente Rab-bi, la ilahe il-la ente, khalekteni ue ene abduke, ue ene ala ahdike ue va’dike mesteta’tu. Eudhu bike min sherri ma sana’tu! Ebu’u leke bi ni’metike aleje, ue ebu’u bi dhenbi, fegfir li, fe in-nehu la jegfiru dhunube il-la ente.”

(O Allah, Ti je Zoti im. S’ka të adhuruar tjetër të vërtetë përveç Teje. Ti më ke krijuar dhe unë jam robi Yt. Do t’i qëndroj besnik zotimit dhe marrëveshjes me Ty, sa të kem mundësi. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja që kam vepruar! Unë jam mirënjohës ndaj dhuntive të Tua. I pranoj mëkatet e mia, prandaj më fal, sepse mëkatet nuk mundet t’i falë askush tjetër përveç Teje!”²⁶

²⁶ I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kush e thotë gjatë ditës me bindje në të, e nëse vdes gjatë ditës para së të ngrysë, ai do të jetë nga banorët e xhenetit, e nëse e thotë gjatë natës i bindur në të, e vdes para se të gdhijë, ai do të jetë nga banorët e Xhenetit.” E transmeton Buhariu me nr 6306 dhe nga Sheddad bin Eusi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

92.Pyetja e nëntëdhjetenjëte: **Cila është lutja që preferohet ta themi kur shtrihemi për të fjetur?**

Përgjigjja: “Bismike Allahume emutu ue ehja!”

(Me emrin Tënd o Allah jetoj dhe vdes.)

93.Pyetja e nëntëdhjetedyte: **Cila është lutja që preferohet ta themi kur zgjohemi nga gjumi?**

Përgjigjja: “Elhamdu lilahi el-ledhi ehjana ba’de ma ematena ue ilejhi nushur”

(Lavdëruar qoftë Allahu, i Cili na ringjalli pasi që ishim të vdekur, dhe tek Ai do të jetë tubimi në Ditën e Gjykimit).²⁷

²⁷ E transmeton Buhariu në Fet’hul Bari 11/113 dhe Muslimi 4/2083.

94.Pyetja e nëntëdhjetetretë: **Si e përshëndesin muslimanët njëri-tjetrin?**

Përgjigjja: “Esselamu alejkum ue rahmetullahi ue beraketuh!”

(Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju!)

95.Pyetja e nëntëdhjetekatërt: **Cilën dorë përdor muslimani për të ngrënë dhe për të pirë?**

Përgjigjja: Dorën e djathtë.

96.Pyetja e nëntëdhjetepestë: **Kur duhet të themi ‘Bismilah’ – Me emrin e Allahut?**

Përgjigjja:

- a. Para ngrënies dhe pirjes
- b. Para se të hyjmë në tualet
- c. Para se të futemi në xhami
- d. Pas daljes nga xhamia
- e. Para se të zhvishemi

97. Pyetja e nëntëdhjetegjashtë: **Kur duhet të themi ‘Elhamdulillah’ – Falënderimi dhe laudërimi i takon Allahut?**

Përgjigjja:

- a. Pas ngrënies dhe pirjes
- b. Pas teshtimës
- c. Kur na ndodhin mirësi që na gëzojnë
- d. Muslimani thotë ‘Elhamdulillah’ në çdo gjendje që të jetë

98. Pyetja e nëntëdhjeteshtatë: **Çfarë duhet t’i themi dikujt i cili teshtin dhe thotë ‘Elhamdulillah!’? Po ai si duhet të na përgjigjet?**

Përgjigjja: **I themi ‘JerhamukeAllah’ – Allahu të mëshiroftë!**

Ndërsa pala tjetër përgjigjet duke thënë: **‘Jehdikumullah ue juslihu balekum!’**

– Allahu ju udhëzoftë dhe gjendjen ua përmirësoftë!

99.Pyetja e nëntëdhjetetë: **Plotëso hadithin: I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Atij njeriu të cilit Allahu ia do të mirën...**

Përgjigjja: “... ia bën të kuptueshme fenë.”²⁸

100.Pyetja e nëntëdhjetenëntë: **Cilat janë vendet më të dashura për Allahun dhe cilat janë vendet më të urryera?**

Përgjigjja: **Vendet më të dashura për Allahun janë xhamitë dhe vendet më të urryera janë tregjet.**

²⁸ E transmeton Buhariu me nr 7312 dhe Muslimi me nr 1037, nga Muavija (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

101. Pyetja e njëqindtë: **Cila është dita më e mirë e javës?**

Cila është dita më e mirë e vitit?

Cila është nata më e mirë e vitit?

Cili është muaji më i mirë i vitit?

Përgjigjja:

- Dita më e mirë e javës është dita e premte (Xhumaja)

- Dita më e mirë e vitit është dita e Arafatit

- Nata më e mirë e vitit është Nata e Kadrit

- Muaji më i mirë i vitit është muaji Ramazan.

102. Pyetja e njëqindnjëtetë: **Cilat janë festat e muslimanit?**

Përgjigjja: **Fitër Bajrami dhe Kurban Bajrami**


103. Pyetja e njëqindedytë: **Cilët janë Kalifët e Drejtë?**

Përgjigjja:

1. **Ebu Bekër Es Sidiku** (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!)
2. **Umer ibnul Hatabi** (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!)
3. **Uthman ibën Affani** (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!)
4. **Ali ibën Ebi Talibi** (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!)



*Përfunduan pyetjet së bashku
me përgjigjet përkatëse.*



*Falënderimet dhe lëvdatat
i takojnë Allahut për gjithçka!
Paqja, mëshira dhe bekimet
e Allahut qofshin mbi Profetin tonë;
Muhamedin, mbi familjen e tij
të ndershme dhe shokët e tij fisnikë!*

